

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** - Departamenti për Krime të Rënda, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Skender Çoçaj si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarët Kymete Kicaj dhe Refki Piraj si anëtarë të trupit gjykues, e me procesmbajtësen Birsën Kume - sekretare juridike pranë kësaj gjykate, duke vendosur në lëndën penale, sipas Aktakuzës së Prokurorisë së Shtetit me emërtimin, PP.nr. 311/2014 kundër të akuzuarve L. S., B. Xh., për shkak të veprës penale të trafikimit me njerëz nga neni 171, par.1, lidhur me nenin 31 të KP-së, dhe të akuzuarve M. G. dhe E. K., për shkak të veprave penale, shërbime seksuale me viktimën e trafikimit nga neni 231, par.1 të KP-së, në shqyrtimin gjyqësor, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Genc Nixha, të akuzuarve, si dhe mbrojtësve të të akuzuarve, me datë 15.06.2015, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### Të akuzuarit:

**L. S.**, nga i ati F. dhe e ëma F. e vajzërisë M., data e lindjes..., në Prizren, ku edhe tani jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

**B. XH.** nga i ati H. dhe e ëma E., e vajzërisë Sh., data e lindjes..., në Prizren ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**M. G.**, nga i ati I. dhe e ëma Xh., e vajzërisë S., data e lindjes..., në Prizren, ku edhe tani jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

**E. K.** nga i ati S. dhe e ëma K., e vajzërisë B., data e lindjes..., në fshatin K., KK Prizren ku edhe tani jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

#### I.

Në bazë të nenit 364 paragrafi 1 pika 1.3 të KPP-së.

### LIROHEN NGA AKUZA

#### 1. I akuzuarit **M. G.**

Se në periudhë të pacaktuar të vitit 2013 në fshatin P. në restorantin "P" shfrytëzon shërbime seksuale të viktimës së trafikimit, në rastin konkret të viktimës Sh. B., në atë mënyrë që duke qenë shok me të pandehurin L. S., ka marrë viktimën dhe me veturën e tij së pari kanë shkuar në restorantin "P" ku kanë konsumuar pije alkoolike e më pas janë ndalur në fshatin Reçan po në automjetin të cilin e ka drejtuar, ka shfrytëzuar shërbime seksuale të viktimës Sh. B. përkundër

dëshirës së saj, me ç rast edhe ia ka dorëzuar shumën prej 20 euro dhe më pas sërish është kthyer në fshatin Reçan ku e kishte prituri i akuzuari L. S. dhe të njëjtit janë kthyer në Prizren.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale shërbime seksuale me viktimën e trafikimit nga neni 231 par.1 të KP-së.

## 2. I akuzuari **E. K.**

Se në periudhë të pacaktuar të vitit 2013 në Prizren në restorantin “Pa.” shfrytëzon shërbime seksuale të viktimës së trafikimit në rastin konkret të viktimës Sh. B., në atë mënyrë që duke qenë shokë me të pandehurin L. S. ka kërkuar nga i njëjti që të detyrojë të dëmtuarën Sh. të ketë marrëdhënie seksuale me të dhe në këtë mënyrë e dëmtuara Sh. është sjellur në motelin në fjalë me taksitë cilën e ka drejtuar i akuzuari B. Xh. dhe më pas ka shkuar në dhomë ku ka qenë duke prituri i akuzuari E. K., me ç rast i njëjti ka shfrytëzuar shërbime seksuale të viktimës Sh. B. përkundër dëshirës së saj.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale shërbime seksuale me viktimën e trafikimit nga neni 231 par.1 të KP-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## II.

### JANË FAJTOR

#### 1. I akuzuari **L. S.**

Sepse gjatë muajve Shtator-Tetor 2013, në Prizren, kryenë veprën penale të mundësimit ose detyrimit për prostitucion, në atë mënyrë që i akuzuari L. S. duke e mbajtur në situatë të varësisë personale e detyron të dëmtuarën Sh. B., shtetase e Republikës së Shqipërisë, me banim të përkohshëm në Prizren që të merret me prostitucion ashtu pasi që me të njëjtën vendoset me një shtëpi banimi në afërsi të përmendores së “Pal Paluca”, e detyruar të ofrojë shërbime seksuale me pagesë, me persona të tjerë, në atë mënyrë që në dy raste e ka detyruar të dëmtuarën të ketë marrëdhënie seksuale në rastin e parë me M. G. dhe atë në një automobil në afërsi të fshatit Reçanë për shumën prej 20 euro dhe në rastin e dytë me personin e quajtur E. K. nga fshati K. me të cilin ka patur marrëdhënie seksuale në motelin “Pa.” në Prizren për të cilin shërbim E. K. i ka paguar të pandehurit L. shumën prej 50 euro ndërsa të dëmtuarës ia ka dhënë shumën prej 30 euro dhe në momentin kur viktimë Sh. B. ka hypë në taksitë cilin e ka drejtuar i akuzuari B. Xh. i akuzuari L. S. ia merre edhe shumën e të hollave të cilin E. K. ia kishte dhënë asaj.

Këso dore ka kryer veprën penale të mundësimit ose detyrimit për prostitucion, nga neni 241, par.3 të KP-së,

#### 2. I akuzuari **B. Xh.,**

Sepse në kohë dhe vend të njëjtë sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi e ndihmon të akuzuarin L. S. ashtu që me automjetin e tij taksitë e ka transportuar viktimën dhe të akuzuarin L. S. në destinacionet si motel “P”, fshati Reçanë, në shtëpinë e malorëve si dhe në destinacione tjera ku viktimë e dëmtuara Sh. B. detyrohej të ofronte shërbimet seksuale të cilat i akuzuari L. S. i gjindëte.

Këso dore ka kryer veprën penale të mundësimit ose detyrimit për prostitucion, në ndihmë, nga neni 241, par.3 lidhur me nenin 33 të KP-së.

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitës së lartshënuar dhe neneve 3, 4, 7, 41, 42, 43, 46, 73 dhe nenit 241, par. 3 lidhur me nenin 33 të KP-së, të akuzuarit i:

## **G J Y K O N**

1.Të akuzuarin **L. S.** e dënon me gjobë në lartësinë prej 2000 (dymijë) Euro të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do t'i llogaritet një ditë burgimi dhe,

-me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 18.11.2014 e deri me datën 15.06.2015.

2.Të akuzuarin **B. XH.** e dënon me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) Euro të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do t'i llogaritet një ditë burgimi dhe,

-me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh.

E dëmtuara Sh. B. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Të akuzuarit L. S. dhe B. Xh. obligohen që në mënyrë solidare t'i paguajnë shpenzimet procedurale si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 300 Euro, secili nga 150 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar Aktakuzën me numër të rastit, PP.nr. 311/2014, të datës 31.12.2014, kundër të akuzuarve L. S., B. Xh., për shkak të veprës penale të trafikimit me njerëz nga neni 171, par.1, lidhur me nenin 31 të KP-së si dhe kundër të akuzuarve M. G. dhe E. K. për shkak të veprës penale shërbime seksuale me viktimën e trafikimit nga neni 231, par.1 të KP-së. Prokurori i çështjes në fjalën e tij përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës, ka deklaruar se duke u bazuar në rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor, nga provat e administruara, si dhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, me pa mëdyshje është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve, në këtë çështje penale, janë formuar elementet e veprës penale dhe atë për të akuzuarin L. S., vepra penale e trafikimit me njerëz nga neni 171 i KP-së, për të akuzuarin B. Xh., vepra penale e trafikimit me njerëz në ndihmë nga neni 171 në lidhje me nenin 33 të KP-së, si dhe për të pandehurit M. G. dhe E. K. për kryerjen e veprës penale, shërbime seksuale me viktimën e trafikimit nga neni 231, par.1 të KP-së, andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtët t'i shpall fajtor dhe t'i dënoje sipas ligjit.

Të akuzuarit L. S., B. Xh. dhe M. G. dhe E. K. gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, nuk e kanë pranuar fajësinë për veprën penale e cila u vihet në barrë sipas aktakuzës së Prokurorisë, PP.nr.311/2014 të datës 31.12.2014.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka nxjerr të gjitha provat e domosdoshme dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave në tërësi ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Në tërësi është vërtetuar se i akuzuarit L. S. gjatë muajve Shtator-Tetor 2013, në Prizren, kryen veprën penale të mundësimit ose detyrimit për prostitucion, në atë mënyrë që i akuzuari L. S. duke e mbajtur në situatë të varësisë personale e detyron të dëmtuarën Sh. B., shtetase e Republikës së Shqipërisë, me banim të përkohshëm në Prizren që të merret me prostitucion ashtu pasi që me të njëjtën vendoset me një shtëpi banimi në afërsi të përmendores së “Pal Paluca”, e detyruar të ofrojë shërbime seksuale me pagesë, me persona të tjerë, në atë mënyrë që së paku në dy raste e ka detyruar të dëmtuarën të ketë marrëdhënie seksuale në rastin e parë me M. G. dhe atë në një automobil në afërsi të fshatit Reçanë për shumën prej 20 euro dhe në rastin e dytë me personin e quajtur E. K. nga fshati K. me të cilin ka patur marrëdhënie seksuale në motelin “Pa.” në Prizren për të cilin shërbim E.K. i ka paguar të pandehurit L. shumën prej 50 euro ndërsa të dëmtuarës ia ka dhënë shumën prej 30 euro dhe në momentin kur viktimë Sh. B. ka hyp në taksì të cilin e ka drejtuar i akuzuari B. Xh. i akuzuari L. S. ia merre edhe shumën e të hollave të cilin E. K. ia kishte dhënë asaj.

Sepse në kohë dhe vend të njëjtë sikurse në dispozitivin nën I.të këtij aktgjykimi i akuzuari B. Xh. e ndihmon të akuzuarin L. S. ashtu që me automjetin e tij taksì e ka transportuar viktimën dhe të akuzuarin L. S. në destinacionet si motel “Pa.”, fshati Reçanë, në shtëpinë e malorëve si dhe në destinacione tjera ku viktimë e dëmtuara Sh. B. detyrohej të ofronte shërbimet seksuale të cilat i akuzuari L. S. i gjindte.

Gjykata sa i përket të akuzuarve L. S. dhe B. Xh. ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga vepra penale trafikim me njerëz të kryer në bashkëkryerje nga neni 171 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së në veprën penale mundësim ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 par. 3, pasi që bazuar në dispozitat e Kodit Penal të Kosovës që të ekzistojë vepra penale të trafikimit me njerëz e dëmtuara duhet të jetë viktimë e trafikimit ndërsa në rastin konkret gjykata konsideron se e dëmtuara Sh. B. nuk është viktimë e trafikimit pasi që e njëjta dy vite para se të takohej me të akuzuarin L. S. kishte ardhur në Kosovë, e njëjta ishte e vendosur në shtëpinë e të afërmit të saj, po ashtu e dëmtuara ishte duke punuar si pastruese dhe se me dëshirën e saj është takuar dhe ka pirë kafe me të akuzuarin L. S., pra në këto rrethana gjykata konsideron se e dëmtuara Sh. B. nuk është viktimë e trafikimit por është viktimë e prostitucionit nga se ka qenë e shfrytëzuar nga L. S. për të ushtruar prostitucion respektivisht për tu ofruar shërbime seksuale personave të ndryshëm në mënyrë që L. S. të përfiton materialisht. Gjithashtu gjykata konstatoi se nuk është vërtetuar se i akuzuari L. S. ta ketë mbajtur me dhunë duke e mbyllur në shtëpinë ku kanë qëndruar së bashku të dëmtuarën Sh., pasi që nga vet deklarata e të dëmtuarës rezulton se e njëjta disa herë me taksì ka dal nga ajo shtëpi dhe e njëjta ka poseduar telefon dhe në një moment të caktuar largohet nga i akuzuari L. S., pra edhe për këtë arsye gjykata nuk e ka konsideruar si viktimë të trafikimit.

E dëmtuara Sh. B. gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se nga Shqipëria ka ardhur me tezen e babit të saj dhe është vendosur te shtëpia e çikës së tezës së babit V. M., ku ka qëndruar për dy vite, gjatë kësaj periudhe ka punuar si pastruese. Me tej ka deklaruar se me të akuzuarin L. S. për herë të parë është takuar në qytet, me të njëjtin ka pirë kafe dhe pastaj kanë shkuar në mal, ku kanë qëndruar deri në ora 5 të mëngjesit, dhe aty i akuzuari e ka kërcënuar se ka me shti njerëz me dhunua, pastaj ka vazhduar me thirr vazhdimisht ne telefon duke i thënë që sma qel telefonin skam me të lënë rahat. Ka theksuar se me të akuzuarin L. S. ka qëndruar për 3 muaj në një shtëpi të marr ur me qira nga ai, ku shumicën e kohës kemi nejt në atë banesë dhe gjatë këtyre dy muajve L. ka prur

njerëz të cilët kanë kryer marrëdhënie seksuale me të, ka pasur raste kur L. e ka lënë vetëm në banesë dhe ia ka mbyll derën, ndërsa e njëjta nuk ka pasur çelësat e asaj banese. Në vazhdim ka theksuar se nuk e din se si quhej një vend ku e kishin kaluar natën së bashku me L. S. dhe B. Xh. i cili kishte shkuar si taksist aty kishte kryer marrëdhënie seksuale me L. S. i cili pas kësaj i kishte thënë se nëse nuk kryen marrëdhënie seksuale me B. kam me të lënë këtu e për këtë arsye nuk ka pas se çka të bëjë tjetër përveç se të bënte çka i thoshte L. ndërsa B. i kishte thënë se kështu i ka thënë L. që duhet me kry marrëdhënie seksuale me ty, e dëmtuara e kishte lutur B. duke i thënë “pash zotin mos më ban kurrjë” ndërsa B. i kishte thënë “skam çka met ba duhet me bo”. E dëmtuara ka shtuar se sa herë B. ka vozitur me taksit ka qenë sipas kërkesës së L. S. Në dyqanin e E. K. ka shkuar me L. S. ndërsa në lokalit “B.” ka shkuar me E. thjesht se ka vepruar çka i ka thënë L. S., aty E. nuk ka përdorur dhunë thjeshtë ka kryer punë dhe është larguar, dhe i njëjti nuk e ka ditur se ajo është nga Shqipëria.

Gjykata duke analizuar dëshminë e të dëmtuarës të njëjtës ia fali besimin dhe nga kjo deklaratë u vërtetua se deri te njohja me të akuzuarin L. S. kishte ardhur edhe me dëshirën e të dëmtuarës pasi që e njëjta ka deklaruar se me të akuzuarin L. ishte takuar në Shatërvan dhe ishte ulur me të dhe kishte pirë kafe me dëshirën e saj. Gjithashtu nga deklarata e të dëmtuarës është vërtetuar se e njëjta një kohë të caktuar kishte qëndruar me të akuzuarin L. në shtëpinë e marrë me qira nga vet L. dhe se në atë shtëpi ishte detyruar që pa dëshirën e saj të ketë marrëdhënie seksuale me pagesë, e gjithashtu të dëmtuarën e kishte detyruar që të ketë marrëdhënie seksuale me pagesë edhe me M. G. dhe atë së paku me një rast kur rrugës gjatë kthimit nga restoranti “P.” në fshatin P. ndalen në fshatin Reçanë dhe kryejnë marrëdhënie seksuale fakt këtë që e pranon edhe vet M. G. i cili në deklaratën e tij ka deklaruar se pasi që kanë kryer marrëdhënie seksuale i kishte dhënë të holla të dëmtuarës gjoja për shkak se e njëjta ishte ankuar për gjendjen e saj të keqe ekonomike. Po ashtu e kishte detyruar të ketë marrëdhënie seksuale me pagesë edhe me E. K. dhe atë së paku në një rast në hotelin “Pa.” fakt të cilin e vërteton edhe e dëmtuara por edhe E. K. i cili në deklaratën e tij e ka pranuar se kishte kryer marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën Sh. B. Nga e gjithë kjo gjykata ka vërtetuar se i akuzuari L. S. i ndihmuar edhe nga i akuzuari B. Xh. kanë ushtruar veprimtarinë e prostitucionit në atë mënyrë që i akuzuari L. duke gjetur persona të caktuar në këmbim të një pagese të caktuar e shtyn të dëmtuarën Sh. të ketë marrëdhënie seksuale e përmes ndihmës nga i akuzuari B. Xh. i cili e dërgonte të dëmtuarën në vendet ku duhej të kryej marrëdhënie seksuale.

Gjithashtu edhe M. G. nuk ka përdorur dhunë kur kanë pasur marrëdhënie seksuale por i njëjti shpesh herë ka shkuar në shtëpinë ku rrinte e dëmtuara dhe ka kryer marrëdhënie seksuale me të dhe ka ndodhur që ai vet i ka lënë të holla për këtë punë, ndërsa nuk e dinte se E. dhe M. kur kanë pasur marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën a e ka ditur se për këtë vendos L. e jo vet e dëmtuara, ndërsa që të shkonte në hotel “Pa.” dhe të ketë marrëdhënie seksuale me E. dhe M. i kishte thënë L. S. Në fund e dëmtuara ka shtuar se rastin nuk e kishte paraqitur më herët pasi që kishte menduar se kjo gjë është kaluese deri sa një natë ishte duke i hapur teshat në tel dhe e ka dëgjuar zërin e L. S. dhe menjëherë është alivanosur, për çka të nesërmen e ka lajmëruar rastin në polici.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjykata ka dëgjuar edhe dëshmitarin Gj. B., si dhe ka bërë edhe shikimin në fotodokumentacion ku shihet fotoja e të dëmtuarës Sh. B., letërnjoftimi i saj i lëshuar nga Republika e Shqipërisë gjithashtu shihen edhe fotokopjet e letërnjoftimit të akuzuarit L. S., të akuzuarit B. Xh., dhe të akuzuarit E. K.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjykata ka lexuar raportin e Oficerit të Policisë së Kosovës me nr. të rastit 2014-DHTQNJ-81 të dt. 17.12.2014 nga i cili raport vërtetohet se i akuzuari L. S. ka qenë në kontakt me E. K. dhe M. G.

Dëshmitari Gj. B. gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka deklaruar se të akuzuarit L. S. ia ka lëshuar shtëpinë me qira të cilit ia kishte dhënë dy çelësat e derës së hyrjes së shtëpisë, shtëpia i

kishte dy dhoma, banjë dhe kuzhinë, në atë shtëpi i ka parë duke ndenjur 4 persona të akuzuarin L., një djalë dhe dy vajza, në mesin e të cilëve edhe të dëmtuarën të cilën e kishte parë një ditë në mbrëmje kur dëshmitari kishte shkuar në atë shtëpi që ta rregullonte një problem me rrymën, ka shtuar se nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi apo ndonjë veprim të dyshimtë në atë shtëpi, gjithashtu nuk ka pasur ndonjë ankesë nga Sh. B. apo L. S., në vazhdim ka deklaruar se i akuzuari B. Xh. i dukej i njohur, mirëpo në shtëpinë e tij nuk e kishte parë asnjëherë as edhe të akuzuarit tjerë nuk kishin qenë në këtë shtëpi.

Nga deklarata e dëshmitarit Gj. B. gjykata ka vërtetuar se i akuzuari L. S. kishte marr me qira shtëpinë e dëshmitarit e në të cilën shtëpi kishin qëndruar i akuzuari dhe disa persona në mesin e tyre edhe e dëmtuara Sh. B.

I akuzuari L. S., gjatë shqyrtimit gjyqësor, në mbrojtjen e tij ka deklaruar se me të dëmtuarën Sh. B. është takuar në shatërvan e dinte se e njëjta është nga Shqipëria, ajo i kishte kërkuar atij që ta strehojë pasi që nuk kishte se ku të shkonte, ka shtuar se ka pasur qëllim të mirë me të dëmtuarën dhe se nuk e ka mbajtur me dhunë në banesën e tij, por ka qenë bashkëjetesë më dëshirë me të cilën ka qëndruar 10-15 ditë në banesën të cilën e kishte marrë me qira. Ka theksuar se e dëmtuara ka pasur telefon dhe qelës të banesës dhe ka qenë e lirë të largohet në çdo kohë. Më tej ka mohuar të ketë ftuar njerëz në banesë për shërbime seksuale me Sh. B. Në vazhdim në mbrojtjen e tij i akuzuari ka deklaruar se gjatë kohës kur ka qëndruar me të dëmtuarën Sh. B. ka qenë i martuar, ishte martuar para 3 viteve e cila martesë ka zgjatur 2 vite dhe nga kjo martesë ka një fëmijë. I akuzuari ka deklaruar se në lokalit e E. K. i cili ka qenë një market kishte shkuar me të dëmtuarën Sh. dhe se me E. nuk kishte biseduar për ofrimin e shërbimeve seksuale nga e dëmtuara Sh.

Gjykata duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarit L. S. pjesërisht ia falë besimin mbrojtjes së dhënë nga i akuzuari nga se në të vërtetë i akuzuari L. S. e pranon se është njoftuar me të dëmtuarën Sh. B. një ditë të caktuar në Shatërvan ku edhe kanë pirë kafe së bashku gjithashtu se ka marrë një shtëpi me qira në të cilën për një kohë të caktuar ka qëndruar bashkë me të dëmtuarën, mirëpo i njëjti nuk e pranon se të dëmtuarën e ka shfrytëzuar për prostitucion, për çka gjykata kësaj pjese të mbrojtjes së tij nuk ia falë besimin nga se është në kundërshtim me të gjitha provat të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor gjithashtu edhe në kundërshtim në deklaratën e të dëmtuarës Sh. B.

I akuzuari B. Xh., gjatë shqyrtimit gjyqësor, në mbrojtjen e tij ka deklaruar se të akuzuarin L. S. e ka shok të ngushtë të njëjtin e njeh që 1-12 vite, ai kur nuk e kishte urdhëruar ndonjëherë që të vepronte në dëm të dëmtuarës Sh. B., të cilën një herë e kishte vozitur si taksist për në hotelin “Pa.” mirëpo nuk e kishte ditur se po e dërgon për të ofruar shërbime seksuale, por vetëm e kishte dërguar dhe e kishte lënë, në të vërtetë L. e kishte thirr në telefon i njëjti ka shkuar nga shtëpia ku kanë banuar e ka marr Sh. të cilën e thërrisnin “Lola” e kishte pyetur se ku don me shku ajo një herë e kishte thënë te “qylhani” mirëpo duke biseduar me telefon e ka nderuar mendimin dhe ka kërkuar që ta dërgonte te hoteli “Pavarësia” ku edhe e kishte dërguar, e dëmtuara e kishte paguar për këtë shërbim, ndërsa pas një ore i akuzuari L. e kishte thirr në telefon dhe i ka kërkuar që ta shkon ta merr të dëmtuarën të cilën kishte shkuar dhe e kishte marrë në mes tjerash i kishte thënë se nuk je tu bo mirë dhe e kishte pyetur se çka ke ardh këtu ndërsa e dëmtuara ishte përgjigjur se kishte ardhur me u la, e kishte marrë të dëmtuarën dhe e ka dërguar në banesë, për këtë shërbim e kishte paguar L., ka shtuar se e kishte vozitur edhe në vende të tjera. Të dëmtuarën Sh. i akuzuari e kishte njohur e njëjta nuk ishte e dashura e tij, e dinte se ajo ishte nga Shqipëria gjithashtu e dinte se ku banonte, me të njëjtën kishte pasur marrëdhënie seksuale por me dëshirën e saj dhe nuk i kishte paguar për këtë marrëdhënie, e gjithashtu nuk i kishte kryer as ndonjë shërbim, kryer marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën, në shtëpinë e malorëve, pa dijen e L. S., por ka mohuar se e ka bërë me detyrim, por me dëshirën e saj.

Duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarit B. Xh. gjykata konstatoi se edhe për kundër vaktit se i njëjti kur është deklaruar për fajësinë është deklaruar i pafajshëm ai në të vërtetë edhe për kundër faktit se ka deklaruar se nuk ka vepruar ndonjë herë në dëm të dëmtuarës Sh. B. ai e pranon se së paku një herë e kishte dërguar të dëmtuarën në hotelin “Pa.” e gjithashtu e kishte dërguar edhe në vendet tjera të ndryshme, e krejt këto me urdhër të L. S.

I akuzuari M. G., gjatë shqyrtimit gjyqësor, si në deklaratën e tij të dhënë para prokurorit ka deklaruar se kanë qenë duke ardhur te poshtë nga restorani “P.” në P. diku në Reçanë ka zbritur L. të cilit i ka thënë deri sa ishin në restorant së bashku me të dëmtuarën me të cilën ishte marrë vesh që të shkonte në një hotel dhe të kenë marrëdhënie seksuale, pas kësaj e dëmtuara i ishte ankuar atij se nuk kishte para me hangër bukë e as ta paguaj banesën për këtë arsye ia kishte dhënë 20 euro. Të dëmtuarën Sh. e kishte njohur para të gjithëve e dinte se ku ka qëndruar e kishte takuar pasi që ajo kishte shkuar në kafiqin ku i akuzuari punonte, por nuk e ka ditur se me çka merrej Sh., nuk e dinte se çka punonte vetëm se shpesh herë e njëjta kishte shkuar në kafiqin ku punonte i akuzuari dhe shpesh herë kishte ndodh që e dëmtuara edhe vonë në 2 të natës të shkonte në çajtores në Jeni Mahall ku ata luanin letra.

I akuzuari E. K., gjatë shqyrtimit gjyqësor, në mbrojtjen e tij ka deklaruar se të dëmtuarën për herë të parë e ka njoftuar në market të tij kur e njëjta ka ardhur me të akuzuarin L. S. për të blerë sende dhe ka blerë edhe një mbushje elektronike prej 1 Euro, të cilën i akuzuari ia ka dërguar nga telefoni i tij në të sajën, pastaj ka vërejtur se automobili nuk po ju punonte, ka dalë me ju ndihmua dhe se ka marrë disa shenja, të cilat i ka kuptuar si ftesë për takim, pastaj e ka thirrur një ose dy herë në telefon dhe se kanë lënë takim në hotelin “Pa.” ku edhe janë takuar, kanë kryer marrëdhënie seksuale dhe janë ndarë. Ka theksuar se vetëm një herë ka kryer marrëdhënie me të dëmtuarën, nuk ka paguar diçka dhe se nuk ka pasur ndërmjetës, të dëmtuarës ai vet i kishte telefonuar pasi që e kishte numrin e saj të telefonit të cilës ia kishte dërguar mbushjen elektronike prej 1 eurove të cilën e kishte marrë atë ditë kur ka qenë në lokalën e të akuzuarit së bashku me L. S.

Nga të gjitha provat e administruara, nga dëgjimi i dëshmitarëve, gjykata konstatoi se nuk është kontestuese se i akuzuari L. S. është takuar dhe njohur me të dëmtuarën Sh. B. gjatë vitit 2013 në Prizren në Shatërvan ku edhe kishin pirë kafe së bashku në një lokal dhe aty kishin filluar që të takohen së bashku. E dëmtuara Sh. B. ishte nga Shqipëria dhe e njëjta në Kosovë kishte ardhur 2 vite para këtij rasti ishte vendosur te i afërmi i saj, ku edhe kishte filluar që të punonte si pastruese. Me të akuzuarin L. S. e njëjta kishte qëndruar për një kohë të caktuar në një shtëpi në Prizren të cilën e kishte marrë me qira vet i akuzuari L., në atë shtëpi i akuzuari shpesh herë kishte sjellë njerëz që të kenë marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën. Gjithashtu nuk është kontestuese se me urdhër të akuzuarit L. S. e në këmbim të parave e dëmtuara pa dëshirën e saj kishte kryer marrëdhënie seksuale me të akuzuarin B. Xh. si dhe me M. G. dhe E. K., fakt ky i vërtetuar edhe nga deklaratat e të dëmtuarës dhe pjesërisht edhe nga deklaratat e të akuzuarit B. Xh. dhe M. G. e E. K.. Se i akuzuari B. Xh. e ka ndihmuar të akuzuarin L. S. është vërtetuar nga vet mbrojtja e tij i cili e pranon se të dëmtuarën së paku një herë e kishte dërguar në restorantin “Pa.” por gjithashtu edhe herave tjera e kishte dërguar në vende të ndryshme.

Gjykata nga të cekurat më lartë, padyshim ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve L. S. dhe B. Xh., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të mundësimit ose detyrimit për prostitucion, përkatësisht të mundësimit ose detyrimit për prostitucion në ndihmë, nga neni 241, par.1, lidhur me nenin 33 të KP-së, prandaj edhe të njëjtët i shpalli fajtor dhe u shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket të akuzuarve M. G. E. K. gjykata të njëjtit i ka liruar nga akuza për faktin se duke pasur parasysh se ka bërë rikualifikimin e veprës penale sa i përket të akuzuarve L. S. dhe B. Xh. atëherë në veprimet e të akuzuarve M. G. dhe E. K. nuk formohen elementet e veprës penale të cilat

ju vihen në barrë me aktakuzë, pasi që prostitucioni nuk paraqet vepër penale por vepër kundërvajtëse.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit dhe llojit të tij, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në neni 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Sa i përket të akuzuarit L. S. prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve, se i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike, është i martuar, baba i një fëmiu, mbajtës të vetëm të familjes, në gjykim kanë pasur qëndrim korrekt, kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese. Sa i përket të akuzuarit B. Xh. prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të njëjtit, se është baba i një fëmiu, është i gjendjes së dobët ekonomike dhe mbajtës i vetëm i familjes, qëndrimin e tij korrekt para gjykatës. Në këto rrethana të lartpërmendura gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KP-së dhe se dënimet e shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit.

Vendimi mbi kërkesën pasurore -juridike është marrë konform nenit 463 par.2 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 451, par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,  
P.nr.3/2015, me datë 15.06.2015**

**Procesmbajtësja  
Birsen Kume**

**Kryetari i Trupit Gjykses  
Skender Çoçaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, ndaj këtij aktgjykimi, në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.